



KOMUNIKATË

22.09.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sot ka bërë certifikimin e 20 subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre që kanë aplikuar për t'u certifikuar në zgjedhjet e 15 nëntorit. Certifikimi është bërë sipas rekomandimeve të Zyres për Regjistrimin e Partive Politike, e cila ka procesuar dokumentacionin e këtyre subjekteve më 18 shtator. Nga këto subjekte 14 janë kandidatë të pavarur, 5 janë iniciativa qytetare dhe 1 parti politike. Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë edhe akreditimin e OJQ –së “National Demokratik Institute – NDI” me 28 vëzhgues.